

VENDIM

Nr.479 date 29.7.1998

PER LIBERALIZIMIN E TARIFAVE TE UJIT TE PIJSHEM

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Liberalizimin e tarifave të ujit të pijshëm.
2. Tarifat e ujit të pijshëm studiohen nga ndërmarrjet administruese të ujit, propozohen nga organet e pushtetit lokal dhe miratohen nga Enti Rregullator i Furnizimit me Ujë dhe i Largimit të Ujerave të Ndotura.
Tarifat mund të jenë fikse, por edhe të diferencuara, në përputhje me limitet e caktuara të përdorimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Enti Rregullator i Furnizimit me Ujë dhe i Largimit të Ujerave të Ndotura, organet e pushtetit lokal dhe ndërmarrjet e ujësjellësit.
4. Deri në miratimin e tarifave të reja, sipas këtij vendimi, ndërmarrjet administruese të ujit të zbatojnë tarifën ekzistuese, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.203, datë 8.5.1997 "Për tarifën e ujit të pijshëm".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano